



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. SM/prot  
4

Tiranë, më 8.4 2022

**VENDIM**  
Nr. 12, Datë 07.04.2022

**“PËR**

**MIRATIMIN BUXHETIT TË VITIT 2022 PËR UNIVERSITETIN E TIRANËS”**

Referuar Ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika h, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.115 / 2021, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 “Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të MASR dhe MFE “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Vendimit Senatit Akademik nr.10 datë 05.04.2022 “Për miratimin përfundimtar të buxhetit të vitit 2022 për Universitetin e Tiranës”, pas miratimit nga anëtarët e Bordit të Administrimit, Bordi i Administrimit :

**Vendosi:**

1. Miratimin Buxhetit vjetor të Universitetit të Tiranës për vitin 2022 si më poshtë vijon:
  - Miratimin e detajimit të kuatave të buxhetit të konsoliduar (Grant mësimdhënie, të ardhura UT) sipas formularit nr.1 bashkëlidhur.
  - Miratimin e detajimit të shpenzimeve operative sipas formularit nr.2 bashkëlidhur.
  - Miratimin e detajimit të investimeve sipas listës me objektet sipas formularit nr.3 bashkëlidhur.
  - Miratimin e numrit të planifikuar të punonjësve sipas formularit nr.4 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori dhe strukturat përgjegjëse në Universitetin e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi. Administratori i UT-së, dhe Administratorët e njëjësive kryesore të kryejnë procedurat e nevojshme për dërgimin e regjistrimit të prokurimeve në APP referuar formularit nr.2, nr.3 bashkëlidhur si dhe në Degën e Thesarit Tiranë për shpërndarjen e buxhetit të miratuar tek njësitë shpenzuese. Administratorët në Fakultete të bëjnë transferimin e fondeve përkatëse në llogarinë e Rektoratit pranë Degës së Thesarit Tiranë për të mbështetur zbatimin e programit të shpenzimeve korente dhe investimeve me financim të brendshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Adela KARAFICI**